


# INSTITUTI EPIK

MAJ 2019

KUADRI KUSHTETUES I PROCESIT TË  
DIALOGUT KOSOVË - SERBI



# HYRJA



Në këtë analizë mëtohet që të vihet brenda kuadrit kushtetues çdo negociim dhe dialogim i Kosovës me Serbinë. Arsyeja për këtë qasje ka të bëjë mbi të gjitha me faktin e thjeshtë se kushtetuta përbën dokumentin më sublim të secilës shoqëri moderne, duke përcaktuar parametrat e ushtrimit të pushtetit, formën dhe përmbajtjen e tij, rolin e individit kundrejt këtij pushteti dhe, mbi të gjitha, bartësin e sovranitetit dhe mënyrën e ushtrimit të tij.

Shoqëritë që i kanë ikur rregullave të kushtetutës, dihet si kanë përfunduar. E kemi fjalën çdoherë për kushtetutat e shoqërive që modelohen sipas parimeve, normave dhe përkushtimeve të liberalizmit perëndimor kushtetues, e jo për vendet që nuk kalojnë testin e këtyre demokracive. Në këtë shoqëri, së cilës i takon Kosova, kushtetuta përbën pikën themelore të referimit, për çështjet fundamentale socio-politike dhe socio-ekonomike, përfshirë këtu çështjet që kanë të bëjnë më promovimin, sigurimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore individuale.

Në shoqëritë si më sipër, ku hynë edhe vendi ynë, ekzistojnë kufij juridik lidhur me burimin e pushtetit dhe formën e organizimit dhe ushtrimit të tij, përfshirë këtu rolin dhe pozitën e individit në shoqëri. Këta kufij juridik përcaktohen në rend të parë me kushtetutë, e cila më pastaj shtjellohet dhe përpunohet me ligje dhe akte tjera juridike (të përgjithshme dhe individuale).

# HYRJA



Dalja jashtë këtyre kufijve juridik mund të bëhet sërish vetëm duke ndjekur procedurën kushtetuese, në veçanti kur kjo dalje ka të bëjë me ndryshimin e natyrës së pushtetit konstituviv që çdoherë i takon sovranit. Mënyrën si sovranit e ushtron këtë dalje nga kuadri i paracaktuar me kushtetutë sërish dhe çdoherë përcaktohet me kushtetutë. Në vendet me traditë demokratike, ky sovran këtë pushtet konstitutiv e ushtron përmes përfaqësuesve të vet dhe, përjashtimisht, kur kjo paraqitet si e domosdoshme, edhe përmes referendumit dhe formave tjera të deklaramit të drejtpërdrejt të sovranit.

Kjo analizë flet për këta kufij dhe për këtë kuadër të përcaktuar me kushtetutë nacionale, në aspektin komparativ, duke shtruar tezat themelore sipas së cilave dialogu dhe negociimi që mëton ndryshimin e parametrave themelor kushtetues që kanë të bëjnë me organizimit e pushtetit, formën dhe përmbajtjen e tij, përfshirë këtu rolin e individit në shoqëri, duhet të bëhet brenda kuadrit juridik të përcaktuar me kushtetutë dhe të shtjelluar më tutje me ligje e akte tjera juridike.

Qëllimi primar i saj, thënë me fjale të tjera, është që të kornizoj dialogun lidhur me pyetjen themelore që sot tundon Kosovën: a ka të drejtë dikush për të negociuar, dialoguar dhe vendosur për sovranitetin territorial të vendit? Nëse ka të drejtë, nën cilat rrethana dhe kushte mund të bëhet dhe sa mund të dilet jashtë kuadrit ekzistues kushtetues për një gjë të tillë?

# HYRJA



Nëse nuk ka të drejtë askush, atëherë analiza paraqet një bazë të mire për arsyetimin e mungesës së një të drejte të tillë. Përgjigja e pyetjes si më sipër, bazuar në analizën në vijim, pritet që të jetë nga aspekti komparativ duke u nisur nga fakti se Kushtetuta e Kosovës, si çdo kushtetutë në vendet demokratike, përmban dispozita që janë jashtëzakonisht të përgjithshme dhe në lexim të parë nuk japin përgjigje në shumë pyetje e tundime të shoqërisë.

Përgjigja çdoherë duhet gjetur në përvojat e popujve tjerë përreth Kosovës dhe më gjerë në vendet perëndimore, gjithnjë duke u nisur nga premisa themelore, se Kosova për momentin është një demokraci kushtetuese parlamentare, me një kushtetutë që bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushtetit dhe në gjithë mekanizmat tjerë institucional për ushtrimin dhe kontrollimin e këtij pushteti, përfshirë këtu rolin dhe pozitën qendrore të lirive dhe të drejtave të njeriut nga kapitujt II dhe III të Kushtetutës.

Në këtë drejtim shpresojmë që analiza jonë do të kontribuoj pozitivisht në ndërtimin e konsensusit të nevojshëm politik, shoqëror, për fuqizimin e pozitës negociuese të palës tonë në dialogun me Serbinë.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Me 15 dhjetor 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoj një rezolutë mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë me një shumicë shumë të brishtë marginale prej 59 votave, pra jashtë asaj që kërkon shpirti dhe fryma e normës kushtetuese 18.1, e cila prek thelbin e identitetit kushtetues dhe nacional të Kosovës, sovranitetin dhe integritetin territorial që çdo herë dhe në çdo fazë kërkon shumicën e votës prej dy të tretave të të gjithë deputetëve të sovranit, pra 80 deputet.

Po ashtu çështjet që derivojnë nga neni 18.1 i Kushtetutës, ato që kanë të bëjnë me territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake, asnjëherë nuk mund të kenë formën e rezolutës apo të një vendimi tjetër që nuk ka fuqi të detyrueshme juridike dhe nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues siç parasheh neni 113.5 i Kushtetutës së Kosovës.

Marrja e mbështetjes prej vetëm 59 votave të deputetëve, reflekton mungesën e thellë të konsensusit si një element vital në këtë proces. Kjo mungese konsensusi përkthehet në mungesë të legjitimitetit politik nga ana e propozuesve të dialogut me Serbinë, gjë që përbën një kusht thelbësor ekstra-kushtetues për suksesin apo dështimin e dialogut: palët që dialogojnë nuk kanë kohezivitet, të brendshëm ashtu që, si të tillë, ato asnjëherë nuk mund të jenë garant të vënies në jetë të detyrimeve eventuale që mund të merren përmes dialogut.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Historia e negocimit dhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mes popujve dhe shteteve tregon se kushti thelbësor për sukses në dialog është legjitimiteti solid në mes palëve dhe konstituencive të tyre ashtu që zotimet e marra në proces dialogimi mund të vihen në jetë pa ndonjë vështirësi.

Rezoluta si më sipër e Kuvendit i kishte vënë vetës disa qëllime, të cilat do materializoheshin me anë të dy dokumenteve pasuese, sot në fuqi, përkatësisht:

1. Ligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me republikën e Serbisë, me të cilin do të definoheshin dhe saktësoheshin kompetencat, përgjegjësitë dhe fusha e veprimit të Delegacionit Shtetëror dhe të përfaqësuesve të tij në Procesin e Dialogut (me tutje: “Ligji për Dialogun”, apo “Ligji”); dhe,
2. Platformës për dialogun e cila do rregullonte parimet udhëheqëse mbi të cilat Delegacioni Shtetëror do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e Dialogut (në tekstin e mëtejshëm: “Platforma për Dialogun” apo “Platforma”).  
Instituti EPIK ka analizuar zotimet e stipuluara në rezolutë, duke i krahasuar ato me Ligjin dhe Platformën. Në bazë të analizës janë nxjerr disa defekte fundamentale që shkojnë në kundërshtim edhe me vetë rezolutën e dhjetorit 2018.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Rezoluta e votuar në dhjetor 2018 parashikon angazhimin brenda Kuvendit të Kosovës për arritjen e një konsensusi sa më të gjerë ndërmjet përfaqësuesve politik, shoqërisë civile dhe qytetarëve të vendit në procesin e dialogut me Serbinë. Tutje, ky konsensus, sipas Rezolutës, thuhet se duhej të arrihej përmes hartimit të një platforme për dialog, ku roli i opozitës do ishte crucial si bashkë prijës në këtë proces.

Kjo si më sipër, pa asnjë ekuivokë, sanksionohej me tone të qarta të zotimeve morale të draftuesve dhe votuesve të Rezolutës së dhjetorit 2018, në kapitullin e saj III, që thotë si vijon: “[...] “Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet për arritjen e një konsensusi sa më të gjerë ndërmjet përfaqësuesve politikë, shoqërisë civile dhe qytetarëve të vendit për Procesin e Dialogut.”

Jo vetëm kaq. Kapitulli në vijim, kapitulli IV i po të njëjtës rezolutë thuhet, në mes tjerash, se “[...] Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë dhe mandatojë, një Delegacion Shtetëror i cili do të jetë entiteti/organi i vetëm i autorizuar për të angazhuar në Procesin e Dialogut”.

Ngjashëm me këtë kapitull shprehet edhe redaktimi i Kapitullit IV pika 3, i Rezolutës, që flet për vendimmarrjen unanime. Aty thuhet se “[...] Vendimmarrja e delegacionit shtetëror do jetë me unanimitet, të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve pjesëmarrëse në procesin e dialogut”.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Për të dhëne fuqi juridike këtyre detyrimeve të synuara, me 7 mars 2019, Kuvendi i Kosovës miratoj me 58 vota pro, Ligjin për Dialogun. Për dallim nga zotimet që i ngërthente në vete Rezoluta, të cilën e shtjelluam si më lartë, Ligji nuk ka arritur të përmbush disa nga këto pozicione dhe zotime publike që ka pasur si qëllim primar Rezoluta e dhjetorit të kuvendit të Kosovës, respektivisht çështjet që lidhen me:

1. Udhëheqjen e dialogut nga delegacioni shtetëror si entitet i vetëm;
2. Vendimmarrjen me unanimitet të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve pjesëmarrëse në procesin e Dialogut;
3. Rolin e opozitës si bllokues të këtij procesi;
4. Kufizimin e mandatit dhe rezervës kushtetuese për të pamundësuar që territori të jetë objekt diskutimi.



# ANALIZA E PËRGJITHSHME

1. Sa i përket udhëheqjes së dialogut nga delegacioni shtetëror si entiteti i vetëm, nëse shikohet me kujdes Ligji mund të vërehet se kur flitet për Delegacionin Shtetëror, në nenin 11, pika 1, thuhet, në mes tjerash se "[...] Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës do të angazhohen në dialog sipas mandatit të tyre kushtetues dhe gjithnjë me bashkërendim dhe me dakordim, në mes të institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit Shtetëror". Me këtë paragraf të nenit 11.1 të Ligjit përgënjeshtrohet Rezoluta e dhjetorit 2018, e cila shpreh garancinë për qytetarin se vetëm Delegacioni Shtetëror do jetë trupa dialoguese me Serbinë.

Këtë e thotë Rezoluta përtej çdo dyshimi në Kapitullin IV si më sipër, në të cilin draftuesit e saj zotoheshin se "[...] Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë dhe mandatojë një Delegacion Shtetëror i cili do të jetë entiteti/organi i vetëm i autorizuar për të angazhuar në Procesin e Dialogut." Tani del se, sipas Ligjit për Dialogun, ekziston një trup tjetër jashtë Kosovës që përcakton se kush përfaqëson Kosovën në dialogun me Serbinë, gjë që mund të shihet nga redaktimi i nenit 11.2 të Ligjit për Dialogun, ku thuhet, në mes tjerash, se "[...] në rastet kur ndonjërit nga Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Presidenti, Kryeministri, Kryeparlamentari, etj.) i dërgohet ftesë formale nga ana e ndërmjetësuesit në procesin e Dialogut, vendimi për të do të merret gjithnjë në bashkërendim dhe dakordim në mes të Delegacionit Shtetëror dhe institucionit kushtetues të ftuar.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Në çdo takim të tillë, përveç institucionit të ftuar të pranishëm do të jenë edhe bashkë drejtuesit e Delegacionit Shtetëror”.

2. Sa i përket vendimmarrjes, Ligji nuk ka arritur që të përmbush kërkesën më të rëndësishme për të siguruar përkrahje të gjerë spektrit politik: Ligji nuk siguron votim me unanimitet siç ka qenë zotimi në kuadër të Rezolutës së dhjetorit 2018 në Kapitullin 4 pika 3, ku thuhet se “[...] vendimet në Delegacionin Shtetëror do të jenë konsensuale.”

Me konsensus do të nënkuptohet procedura e arritjes së pajtimit të njëzëshëm/unanim të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve pjesëmarrëse në procesin e Dialogut. Ajo çfarë bën Ligji për Dialog, në dispozitën e nenit të vet 13.3, konsiston në reduktimin e konsensusit në një arbitraritet që varet nga rrethanat e rastit.

Të shohim se si duket kjo dispozitë e nenit 13.3 të Ligjit:

“[...] Nëse pas dy tentimeve për vendimmarrje dëshmohet se unanimiteti është i pamundshëm, një vendim konsiderohet i miratuar kur i fiton votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë anëtarëve të delegacionit”.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Nga kjo, lë të kuptohet fare lehtë se kjo normë krijon mundësi që me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve të marrin vendime përkatësisht me (8) votat e anëtarëve nga 12 sa janë gjithsej, e jo sipas parimit të konsensusit ose unanimitetit siç ishte proklamuar në Rezolutën e dhjetorit 2018, kapitulli 4 pika 3 e saj. Ky redaktim i ligjit, siç u tha, krijon hapësirë për abuzim dhe mbivotim arbitrar përmes atyre që sot formalisht cilësohen si opozitë, duke reduktuar deri në absurd konsensusin politik, këtë kategori të domosdoshme për suksesin e dialogut tonë me Serbinë.

3. Ligji nuk i ofron opozitës instrumentin legjitim të bllokimit të votimit të çështjeve të rëndësisë së veçantë pasi që opozita me 4 anëtar nuk mund të shfrytëzoj të drejtën e bllokimit të çështjeve respektive, kur neni 13.3 i Ligjit për Dialogun i hap rrugë Delegacionit për vendimmarrje vetëm me 8 anëtar. Pragu i ulët i legjitimitetit të Delegacionit me një shumicë marginale tregon mungesën e konsensusit të gjerë për këtë proces që është element tepër i rëndësishëm në raport me pozicionin negociues të palës tonë.

Në vijim si më sipër, fuqishëm duhet të thuhet se ky Ligj nuk është dashur të caktoj hierarkinë institucionale të institucioneve sepse një gjë e tillë përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Në këtë hierarki, ekzekutivi i vendit ka përparësi, si çdo kund në secilën demokraci kushtetuese parlamentare, kurse Kuvendi shërben si mbikëqyrës konstant kur bëhet fjalë për çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës.

Shefi i shtetit nuk bën pjesë në këtë hierarki sepse ka rol balancues të tri pushteteve dhe institucioneve që përfaqësojnë ato: Presidenti i Republikës nuk ka status vertikal në hierarkinë e organeve shtetërore, as në Kosovë as askund në një demokraci kushtetuese parlamentare.

Thënë me fjale tjera, Presidenti apo Shefi i Shtetit është jashtë tri organeve të pushtetit, duke shërbyer vetëm si balancues dhe sigures i funksionimit normal dhe të rregullt të tri pushteteve tjera (legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit).

Në këtë kuptim, roli balancues i Shefit të Shtetit konsiston në furnizimin me plotfuqi të Delegacionit të Kosovës, në rastet kur në përbërje të tij nuk janë Ministri i Jashtëm dhe Kryeministri, kjo do të thotë Ligji për Dialogun ka mund të rregulloj çështjet tjera, por asnjëherë hierarkinë, sepse hierarkia e organeve kushtetuese është e rregulluar me Kushtetutën e Kosovës dhe përbën prerogativë ekskluzive të sovranit, caktimi i formës institucionale të organizimit të pushtetit shtetëror. Kjo prerogativë ushtrohet me normë kushtetuese e asnjëherë me normë ligjore.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



4. Sa i përket mandatit dhe rezervës kushtetuese, duhet të jetë e qartë që ky mandat i Delegacionit caktohet me vendim të veçantë të Kuvendit, i cili miratohet me shumicën e kualifikuar të të gjithë deputetëve të Kuvendit: çdo dyshim lidhur me mandatin për negociim dhe lidhje të marrëveshjes me Serbinë interpretohet ngushtësisht, gjithnjë duke pas parasysh kompetencat kushtetuese të Kuvendit të Kosovës kundrejt organeve tjera kushtetuese në nivel qendror.

Kuvendi duhet të ngelet organi i vetëm që bën interpretimin e mandatit të Delegacionit në rast të dyshimit. Ky interpretim duhet të bëhet me shumicën e kualifikuar të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Arsyet për këtë janë fare profesionale:

- çështjet e sovranitetit nacional dhe të tërësisë territoriale sipas standardit ndërkombëtar çdoherë interpretohen ngushtësisht. Kjo d.m.th. se nuk mund të prezumohet se ekziston vullneti i shtetit: ai vullnet duhet të jetë i shprehur në mënyrë të qartë dhe sipas procedurave të brendshme kushtetuese. Për këtë arsye asnjë mandat nuk mund të jetë i supozuar në favor të askujt: në rast të dyshimit, ky mandat supozohet se nuk ekziston fare, deri sa organi përfaqësues të mos jep dritën e qarte të gjelbër për sa i përket formës dhe përmbajtjes në të cilën duhet të shprehet ai mandat.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



- lidhja e një marrëveshje eventuale me Serbinë nuk mund të bëhet ndryshe, nisur nga kjo që u tha më lartë rreth mandatit, pos me parafim apo inicializim, duke e vënë kësisoj në dukje në mënyre të qartë rezervën kushtetuese kundrejt palës serbe që territori i Kosovës nuk përben objekt diskutimi dhe vendosje. Kjo qasje përben një akt përmes së cilit pala kosovare e kushtëzon arritjen e marrëveshjes me pëlqimin përfundimtar (ratifikimin) nga ana e Kuvendit të Kosovës në pajtim me nenin 18.1 të Kushtetutës. Kështu kanë vepruar palët nëpër botë në rastet e negociimit dhe vendosjes për çështjet që në Kushtetutën e Kosovës rregullohen më nga neni 18.1. pa asnjë përjashtim. Rasti i Marrëveshjes së Prespës (Maqedonia e Veriut me Greqinë) paraqet rastin e fundit që dëshmon këtë qasje standarde.

Kjo si me sipër, thënë me fjalë tjera, nënkupton se sa i përket çështjeve të parafimit, përkatësisht të nënshkrimit të marrëveshjes së negociuar, Delegacionit çdo here i duhet mandat i ri shprehimor, nga ana e Kuvendit të Kosovës nëse bëhet fjalë për çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës. Po ashtu, nëse objekt i vendimmarrjes së Delegacionit është një çështje nga neni 18.1 i Kushtetutës, atëherë për miratimin e tij do duhet të kërkohej shprehimisht pëlqimi i Kuvendit Kosovës me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

# ANALIZA E PËRGJITHSHME



Këto që u thanë si më sipër lidhur me Rezolutën e dhjetorit 2018 dhe lidhur me Ligjin për Dialogun, e bënë diskutimin për Platformë të panevojshëm sepse ajo ka natyrë jo të detyrueshme për palët, ashtu që ato mund të shmangen çdoherë kufizimeve të vëna aty. Në fakt, Platforma ka kufizime krejtësisht të parëndësishme që nuk çojnë peshë në këtë proces.

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, vendi ka arritur që të konsolidoje shtetësinë e vet duke u njohur nga më shumë se 100 vende të botës, si një shtet sovran dhe i pavarur. Çështja e pavarësisë së Kosovës dhe raportit të saj me të drejtën ndërkombëtare është konfirmuar edhe me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë më tej shkurt : “GJND”), si organi më i lartë gjyqësor i bashkësisë ndërkombëtare, i cili ka legalizuar Deklaratën e Pavarësisë si normën bazike të sistemit kushtetues ne Kosove.

Kosova i takon sistemit të demokracive kushtetuese parlamentare, ku vetëm Kuvendi ka të drejtën për kontroll mbi negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare nga neni 18.1 i Kushtetutës, përkatësisht lidhur me çështjet që kanë të bëjnë, ndër tjera, me territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake etj.

Në shumicën e shteteve që i takojnë sistemit kushtetues parlamentar, kontrolli mbi negociatat për këto marrëveshje ndërkombëtare dhe vetë lidhja e tyre rregullohen me ligj te veçantë ku shprehimisht përcaktohet mënyra e fitimit të mandatit dhe kushtet e negocimit për çështjet që kanë të bëjnë me territorin dhe çështjet tjera të sipërpërmendura. Në Kosovë këtë e bënë ligji respektiv, që normon materien e lidhjes dhe përfundimit të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Aty ku ligji është i heshtur, vlejné normat e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e traktateve.



# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



Kuvendit dhe askujt tjetër i takon që, në cilësinë e përfaqësuesit të sovranit, të marrë vendim lidhur me formatin e dialogut me Serbinë përmes një vendimi të detyrueshëm që themelon dhe mandaton një trupë me një shumicë të kualifikuar për dialogim me Serbinë me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve substanciale me këtë shtet dhe që kanë të bëjnë me çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës.

Një vendim i tillë i Kuvendit i miratuar sipas dispozitave të nenit 18.1 të Kushtetutës asnjëherë nuk mund të ketë formën e rezolutës apo të një vendimi tjetër që nuk ka fuqi juridikisht të detyrueshme. Nuk ka asnjë logjikë juridiko-kushtetuese, politike dhe morale që Kuvendi të legjitimoj një dialog që prek çështjet nga neni 18.1 dhe që mëton të mbyllet me një marrëveshje ligjrisht të detyrueshme me një dokument që vetë nuk ka fuqi juridikisht të detyrueshme dhe nuk plotëson kërkesën e nenit 18.1 për një shumicë të kualifikuar në të gjitha fazat. Për më tepër, nuk ka asnjë logjike kushtetuese, politike dhe morale që Kuvendi të mandatoj një proces që prek çështjet fundamentale kushtetuese dhe ai akt i Kuvendit mos të ketë mundësi për t'iu nënshtruar kontrollit kushtetues nga gardiani i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese.

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



Mungesa e legjitimitetit politik në dialogun me Serbinë përbën një kusht thelbësor për suksesin apo dështimin e dialogut: palët që dialogojnë dhe nuk kanë kohezivitet të brendshëm asnjëherë nuk mund të jenë garant të vënies në jetë të detyrimeve të marra përmes dialogut. Kjo pasqyrohet më së miri në rastin e demarkacionit me Malin e Zi.

Nuk duhet harruar kurrë që çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës prekin thelbin e identitetit kushtetues dhe nacional të Kosovës, sovranitetin dhe integritetin territorial që çdo herë dhe në çdo fazë kërkon shumicën e votës prej dy të tretave të të gjithë deputetëve të sovranit, pra 80 deputet. Kjo shumicë përbën thelbin e një konsensusi minimal që duhet të ekzistoj gjatë tërë procesit negociues dhe dialogues me Serbinë.

Në kuadër të zhvillimeve të fundit lidhura me arritjen e marrëveshjes me Serbinë, Instituti EPIK nënvizon që duhet respektuar me përpikëri rrugën juridiko-kushtetuese të procesit për të ardhur deri te një konsensus politik, dhe jo e kundërta. Ndjekja e kësaj rruge domosdo çon në arritjen e konsensusit minimal brenda spektrit politik kosovar.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se janë 4 hapa kushtetues që duhet respektuar për të arritur deri te marrëveshja përfundimtare me Serbinë.

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



1. Fillimisht, Kuvendi duhet të votoj me 80 vota ekipin negociator, platformën negociuese dhe kufizimet e mandatit negociues. Për të evituar çdo mundësi që territori të jetë objekt i diskutimit në negociata në kuadër të kufizimeve të këtij mandati, Instituti EPIK konsideron se duhet të ketë një pikë të veçantë, që thotë si vijon: Asnjë institucion qendror kushtetues nuk ka të drejtë të negocioj çështje që kanë për objekt diskutimi territorin e Republikës së Kosovës.

2. Pas votimit të ekipit negociator, platformës negociuese dhe kufizimit të mandatit negociues, ekipi negociator ka për obligim që të zhvilloj negociatat nën kontroll të Kuvendit, ku pas çdo raundi të negociatave është i obliguar të raportoj në seancë plenare të Kuvendit. 3. Në fund procesit negociator, marrëveshja e negociuar duhet të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 80 vota të të gjithë deputetëve.

Nga kjo që u tha më lartë, nëse analizojmë sistemet qeverisëse të vendeve të Bashkimit Evropian ekzistojnë tri sisteme të qeverisjes: presidencializmi, gjysmë-presidencializmi dhe parlamentarizmi. Ky i fundit përbënë formën më dominuese të kushtetutave Evropiane. Në të gjitha këto vende, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si sistem i pastër presidencial, i takon vetëm parlamentit dhe askujt tjetër për të negociuar dhe vendosur çështjet që kanë për objekt territorin, paqen, luftën dhe kufijtë shtetëror.

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



Në fund, gjeni bashkëngjitur dy infografika që sqarojnë hapat kushtetues për arritjen e marrëveshjes me Serbinë, si dhe baza ligjore e negocimit të marrëveshjeve që prekin rendin kushtetues dhe territorin shtetëror.

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË



\* Asnjë institucion qendror kushtetues nuk ka të drejtë të negocioj çështje që kanë për objekt diskutimi territorin e Republikës së Kosovës

# HAPAT KUSHTETUES DERI TË ARRITJA E MARRËVESHJES ME SERBINË

Vendi	Baza ligjore	Institucioni	Votat e kërkuara
	Kushtetua Neni 2	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 20 & 59	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 53	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 50 & 68	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 2 & 8 & 81	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 84 & 85	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 11 & 49	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 94	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 28 & 36	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 80 & 87	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 10 & 138	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 115 & 161	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 9	Parlamenti	2/3
	Kushtetua Neni 9	Parlamenti	2/3

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.  
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

